



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 265/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të znj. Kimete Gashi – Kryetare, paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: **OE “S.V. Veterina” sh.p.k -Prishtinë**, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e Deratizimit, Dezinfektimit dhe Dezinsektimit”, me nr. të prokurimit: VU644-22-5147-2-3-6 , inicuar nga AK- KK “Vushtri” , më datën: ..., mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: **OE “S.V. Veterina” sh.p.k - Prishtinë**, kundër njoftimit për kontratë, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e Deratizimit, Dezinfektimit dhe Dezinsektimit”, me nr. të prokurimit: VU644-22-5147-2-3-6 , inicuar nga AK- KK “Vushtri”.

II. ANULOHET, njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Shërbimet e Deratizimit, Dezinfektimit dhe Dezinsektimit”, me nr. të prokurimit: VU644-22-5147-2-3-6 , inicuar nga AK- KK “Vushtri”, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: **OE “S.V. Veterina” sh.p.k -Prishtinë**, i aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: **OE “S.V. Veterina” sh.p.k -Prishtinë**, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 11.07.2022 me nr. 265/22, kundër njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e Deratizimit, Dezinsektimit dhe Dezinsektimit”, me nr. të prokurimit: VU644-22-5147-2-3-6 , inicuar nga AK- KK “Vushtrri, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 1,2,6,7,17,24,27 par.4,28,36,38,59,60,62 dhe 108A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës , si dhe
- Nenin 44 dhe 56.19 të RrUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.07.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt:28.07.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që të anulohet vendimi i AK-Komuna e Vushtrrisë dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 29.07.2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 02.08.2022, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datë: 29.07.2022, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Pa praninë e palëve janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Se të gjitha pretendimet ankimore të OE Ankues lidhur me specifikacionet teknike të detyrueshme qëndrojnë, sepse OE i rekomaduar nuk ka ofruar paisje-aparaturë ULV-ES Elektrostatike- Spërkla në formë uniforme për kryerjen e procesit 3D për spërkatje Uniforme në mënyrë proporcionale që te ketë efekt procesi DDD, andaj aktiviteti i prokurimit kthehet ne rivlerësim.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK “Vushtrri”

1x1 OE - “S.V. Veterina” sh.p.k -Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesja e Panelit Shqyrtues
z.Kimete Gashi

